



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

ENTI KOMBËTAR I OPERIMIT
RRUGOR SH.A

Nr. 28 Prof.
Datë, më 28/01 2026

Nr. 1021 prot.

Tiranë, më 28.1 2026

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 1021, datë 28.1 2026

“MBI MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË “EKORR” SH.A” PËR VITIN 2024”

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar), VKM nr.684, datë 06.11.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a ” (i ndryshuar), Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.10012prot., datë 23.12.2024 “Për themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a, Statutin e shoqërisë, pas shqyrtimit të Pasqyrave Financiare si dhe Raportit të Audituesit të Pavarur, bashkëlidhur shkresës tuaj nr.235prot., datë 24.12.2025, “Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2024”, miratuar me vendimin nr.5 datë 10.12.2025 të Këshillit Mbikëqyrës, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “EKORR” sh.a,

VENDOSA:

1. Miratimin e Raportit të Audituesit të Pavarur, Pasqyrave Financiare dhe rezultatit financiar të shoqërisë “EKORR” sh.a, për vitin 2024.
2. Rezultati i vitit ushtrimor 2024, humbja në vlerën 44,993 lekë të mbartet në Pasqyrat Financiare të vitit pasardhës.
3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “EKORR” sh.a, për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku